



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

A nr. 1080/2013

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Ferit Osmani kryesues, Ymer Hoxha edhe Rafet Haxhaj anëtarë, duke vendosur përkritazi me ankesën e Adelina Ukaj kandidate për anëtarë të Asamblesë Komunale nga radhët e Subjektit Politik Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK) Deçanë, paraqitur kundër Qendrës së Numërimit të Rezultateve (QNR), për shkak të publikimit të rezultateve përfundimtare, në seancën e panelit të mbajtur me 06.12.2013, mori këtë:

VENDIM

Refuzohet si e pabazuar ankesa e Adelina Ukaj kandidate për anëtarë të Asambles Komunale në Deçan nga radhët e Subjektit Politik LDK.

Arsyetim

PZAP-i, më datë 03.12.2013 ka pranuar një ankesë nga Adelina Ukaj është kandidate për Asamble Komunale në zgjedhjet lokale në Komunën e Deçanit e cila pretendon se në disa Qendra të Vendvotimit kam dyshim dhe këto janë : QV- 0102C Dranoc, 0106C Izniq, 0101C,dhe në këtë QV më kanë votuar familja ime , ndërsa po në atë QV nuk kam asnjë votë në rezultatet e KQZ-së

PZAP-i, pasi që shqyrtoj ankesën gjeti se:

Ankesa është e pabazuar

PZAP- konstatoi nga shkresat e lëndës se pretendimet ankimore të Adelina Ukaj, janë të pabazuara, dhe të pa argumentuara, andaj një pretendim i tillë i ankesës u vlerësua si i përgjithshëm dhe i pa argumentuar në prova dhe në dëshmi bindëse nga shkakun se parashtruesi i ankesës nuk i ka bashkangjitur asnjë provë ankesës së parashtruar, me të cilat do të mund të administrohej lënda, ose do të mund të verifikohesh vërtetësia e shkeljes së pretenduar. Prandaj për shkakun se nuk janë ofruar dëshmi bindëse për të vërtetuar shkeljet qe janë cekur ne ankesë , PZAP-i në kuptim të nenit 118 paragrafi 1 të LZP-së, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia

Anr. 1080/2013 më datën 06.12.2013



Këshillë Juridik: Ndaj këtij vendimi mund të paraqitni ankesë në Gjykatën Supreme të Republikës së Kosovës Brenda njezetekater (24) oreve nga momenti i marrjes së vendimit nga PZAP-i.